




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-16004/24 datë:27.06.2024



Npi – 01/236 datë: 04.07.2024

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) si dhe nenin 17 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Nenin 5 shkronja (d) të Ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068; Si dhe në bazë të nenit 6 paragrafit 3 nënparagrafi 3.1 të Udhëzimit Administrativ të (MASH) Nr.151/2020, për Detyrat dhe Përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës-drejtorit të institucionit publik Edukativo-Arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm; Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më: 04.07.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

**FORMOHET KOMISIONI PËR VLERËSIMIN E KANDIDATËVE SIPAS
KONKURSIT PËR ZGJEDHJEN E DREJTORËVE DHE ZËVENDËS-
DREJTORËVE TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE NË KOMUNËN E SHTIMES**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -VII- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 04.07.2024, me shumicën e votave, miratoi Vendimin për formimin e Komisionit për vlerësimin e kandidatëve që kanë konkurruar në të gjitha Konkursset që do të shpallen nga DKA-ja për postin e drejtorit, përkatësisht zëvendës-drejtorit, në Institucionet edukativo-arsimore të komunës së Shtimes, me mandat një (1) vjeçar deri më 04.07.2025, si vijon:

1. z.Rexhep Hasani – Drejtor në SHMU “Emin Duraku” në Shtime,
2. znj.Feride Qorrolli-Lubishtani, mësimdhënëse në Univerzitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, e përfaqësuar në Komision si eksperte e pavarur nga fusha e Arsimit.

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë për Arsimit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi